

VENDIM
Nr.72, datë 19.3.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5228, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5228, datë 19.3.2007 për emërimin e zotit Gazmend Oketa në detyrën e Zëvendëskryeministrit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)